



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
AKREDITIMIT**

Nr. 3330 Prot.,

Datë 20 . 03 . 2018

Nr. 145 Prot.,

Datë 16 . 03 . 2018

Drejtuar: Autoriteteve kontraktore

Lënda: Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (në vijim “DPA”), në kuadër të bashkëpunimit të tyre institucional, referuar parashikimeve të nenit 30 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, me qëllim shmangien e problematikave të hasura në procedurat e prokurimit publik, ku kërkohet paraqitja e certifikatave të cilësisë, vendosën të hartojnë bashkërisht një material orientues.

1. Autoritetet kontraktore, duhet të mbajnë në konsideratë këtë material orientues jo vetëm gjatë hartimit të kriterit për kualifikim mbi paraqitjen e certifikatave që vërtetojnë kërkesat e cilësisë por edhe gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të paraqitura në një procedurë prokurimi, sa i takon hapave që duhet të ndiqen për të verifikuar nëse, një certifikatë e paraqitur në një procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë është lëshuar apo jo nga një organ i vlerësimit të konformitetit dhe nëse, ky organ është akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2. Në hartimin e kriterëve për kualifikim, sa i takon kërkesës për pajisjen me certifikatat e cilësisë autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të gjitha parashikimet ligjore në fuqi, referuar nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 30 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku shprehimisht përcaktohet se:

“Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

3. Në çdo rast, gjatë hartimit të kriterit për kualifikim për paraqitjen e çertifikatave të cilësisë, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë që ky kriter duhet të hartohet në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin që prokurohet, me qëllim krijimin e kushteve për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke respektuar parimin e mosdiskriminimit.

4. Të gjitha çertifikatat e cilësisë, të cilat vlerësohen të nevojshme të kërkojnë nga autoriteti kontraktor, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

5. Ky rekomandim shoqërohet me Manualin teknik “*Mbi mënyrën e marrjes së informacionit për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/ organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë*”.

6. Ky rekomandim hyn në fuqi sot në datë 20.03.2018.

Për Agjencinë e Prokurimit Publik

Drejtor i Përgjithshëm

Reida KASHTA



Për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit

Drejtor i Përgjithshëm

Armond HALEBI



MANUAL TEKNIK

Mbi mënyrën e marrjes së informacionit për organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit/ organizma akreditues të huaj, të cilët kanë nënshkruar marrëveshjen e reciprocitetit me Republikën e Shqipërisë.

1. Cilat janë Organet e Vlerësimit të Konformitetit (OVK)

OVK në bazë të Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, mund të jetë një:

- laborator testues (përfshihen edhe laboratorët mjekësorë)
- laborator kalibrues
- organizëm certifikues i sistemeve të menaxhimit
- organizëm certifikues i personelit
- organizëm certifikues i produkteve
- organizëm inspektues

2. Organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë

Në përputhje me nenin 13, pika 3 të Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, DPA njeh të barazvlefshëm certifikatat e akreditimit të lëshuara nga organizmat akredituese, të cilët kanë nënshkruar marrëveshje të njohjes reciproke (MLA ose MRA) me Organizmin Evropian të Akreditimit (EA), ose Organizmin Ndërkombëtar të Akreditimit të Laboratorëve (ILAC) ose me Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF).

A) Për të marrë informacion, nëse një OVK është e akredituar apo jo nga DPA, autoriteti kontraktor duhet të ndjekë hapat e mëposhtme:

A.1. OVK-të e akredituara nga DPA, lëshojnë certifikata, apo raporte ku përdorin simbolin e akreditimit, i cili përbëhet nga logoja e DPA dhe një numër në formën e mëposhtme:




Nr. XX XXX XX.XX.XX

Secili nga OVK e akredituara ka numrin e tij personal.

Lista e gjithë OVK-ve të akredituara nga DPA gjendet në adresën:
<http://www.dpa.gov.al/sq/organizma-te-akredituara>.

Në kolonën e 6 të tabelës do të merrni informacion mbi afatin e vlefshmërisë së akreditimit, ndërsa në kolonën e 5, jepet fusha e akreditimit. Po të klikoni tek fusha e akreditimit për çdo OVK të akredituar, do t'ju shfaqet në versionin "pdf" certifikata e akreditimit dhe fusha e akreditimit. Në fushën e akreditimit duhet të përfshihet patjetër vlerësimi i konformitetit të objektit të prokurimit.



Nr.	Dt. Akreditimit	Emri	Kodi	Fusha e Akreditimit	Dt. e Mbarimit akreditimit	Adresa
Laboratore te akredituar						
1	17.06.2014 R1 25.03.2015 R2 11.05.2016 PEZULLIM 18.10.2017 MIRRMERITA ITJ 13.12.2017	INSTITUTI I STUDIMEVE AMBIENTALE	LT032	Testimi i gazeve ne ajer dhe zhurma 	16.06.2018	Rr " Islam Alla, nr.34, Tiranë

A.2. Për të marrë informacion nëse certifikata apo raporti i lëshuar nga OVK i akredituar është aktualisht i vlefshëm, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë sa më poshtë vijon:

Për rastin e laboratorëve testues dhe mjekësorë, raporti i testimit jep parametrat e matur, por nuk ka vlefshmëri të raportit. Nëse doni të vërtetoni që një laborator ka lëshuar apo jo një raport testimi, duhet të kontaktoni me laboratorin sipas adresës së dhënë në websitin e DPA.

Për rastin e laboratorëve kalibrues, certifikata e akreditimit ka të shkruar vlefshmërinë e kalibrimit. Nëse nuk shkruhet vlefshmëria e kalibrimit në certifikatë, atëherë duhet të kontaktohet me laboratorin që e ka lëshuar certifikatën, sipas të dhënave në ëbsitin e DPA.

Për rastin e organizmave certifikues dhe inspektues, certifikata apo raporti i lëshuar prej tyre ka vlefshmëri të shënuar në certifikatë. Certifikatat e certifikimit (sipas standardeve ISO, si psh: ISO 9001, ISO 14001, etj) kanë një numër të veçantë për çdo certifikatë. Shkoni në faqen zyrtare të internetit të organizmit certifikues dhe në rublikën "client" vendosni numrin e certifikatës, ku do të merrni informacionin nëse certifikata është ende vlefshme apo jo.

Nëse nuk arrini të merrni informacion në këtë mënyrë, atëherë duhet t'i drejtoheni organizmit certifikues nëpërmjet emailit ose me shkresë zyrtare.

Për rastin e organizmave inspektuese, vlefshmëria e tyre jepet në certifikatë. Informacionin mund ta merrni edhe duke ju drejtuar organizmit inspektues nëpërmjet emailit, ose me shkresë zyrtare.

B) Si veprohet për të marrë informacion, nëse një OVK është akredituar nga organizma akreditues të huaj?

b.1 Organizmat akreditues nënshkrues të marrëveshjeve të njohjes reciproke me EA, ILAC dhe IAF?

b.1.1 Organizmat Evropiane të Akreditimit të cilët janë anëtarë të marrëveshjeve të njohjes reciproke (MLA) me Organizmin Evropian të Akreditimit do t'i gjeni në linkun:

<http://www.european-accreditation.org/mla-and-bla-signatories#1>

The screenshot shows the European Accreditation (EA) website. The header includes the EA logo and navigation links: About EA, The MLA, EA Members, MLA & BLA Signatories (selected), Publications, Communication, and Contact Us. There are also social media links for YouTube and Twitter, and a search bar. The main content area is titled "MLA & BLA Signatories" and "Management Systems Certification". It explains that the EA MLA Signatory Search will help find a list of accredited CABs for a given scope. A sidebar on the left lists various certification types: Calibration, Testing, Product certification, Management Systems Certification (selected), Certification of Persons, Inspection, Validation and Verification, and Proficiency Testing Providers. The main text states: "To find a list of CABs accredited by an MLA signatory for a specific scope, look for the NAB in the Signatory list, sub-section Activities in blue and then look for the scope you are interested and click on 'search'. You will be redirected to the NAB online CAB directory." Below this is a map of Europe with several countries highlighted in blue. To the right of the map, under the heading "BLA Signatories", are listed: Republic Of Moldova : MOLDAC (former CAECF), Tunisia : TUNAC, and Ukraine : NAAU. At the bottom, there are two columns of text: "AUSTRIA" with "AA" and "Akkreditierung Austria" below it, and "BELGIUM" with "BELAC" and "Belgian Accreditation Council" below it.

Në krahun e majtë të tabelës që ju hapet, keni mundësi të zgjidhni fushën e vlerësimit të konformitetit sipas renditjes: kalibrim, testim, çertifikim produkti, çertifikim i sistemeve të menaxhimit, çertifikim personi, inspektim, validim dhe verifikim dhe organizatorët e testeve të zotësisë.

Kur zgjidhni një nga opsionet në krahun e majtë, në krahun e djathtë do të rreshtohet lista e organizmave akreditues (shteti dhe shkurtimi i emrit të organizmit akreditues).

Tek emri i çdo shteti dhe çdo organizmi akreditues, ka të shkruar me blu "**Activities**".

Tek kjo do të gjeni listën e veprimtarive të vlerësimit të konformitetit, për të cilin është nënshkruar marrëveshja e njohjes reciproke, psh, nëse ofertuesi është i çertifikuar nga një organizëm çertifikues i sistemeve të menaxhimit, që është akredituar nga organizmi akreditues italian (shkurtimi i të cilit është ACCREDIA), atëherë në krahun e majtë të faqes <http://www.european-accreditation.org/mla->

[and-bla-signatories#1](#), klikoni: "**management system certification**" dhe në të djathtë, do t'ju shfaqet lista.

Shkojmë poshtë tek ITALY, ACCREDIA dhe tek pjesa që shkruhet me blu "**Activities**" gjeni që ACCREDIA është nënshkrues i marrëveshjeve të njohjes reciproke, përveç të tjerave edhe për "**management system certification**".

ITALY

ACCREDIA

Ente Italiano di Accreditamento

Via Guglielmo Saliceto, 7/9

00161 Roma

Phone: +39 06 8440991

Fax: +39 06 8841199

Website: www.accredia.it

E-mail: trifil@accredia.it

Decision date of the last PE : 10/2015

Date of next reevaluation : 11/2018

Signed PTP for the 1st time in 04/2017

Activities: [Calibration \(search\)](#) | [Testing \(search\)](#) |

[Product certification \(search\)](#) | [Management Systems](#)

[Certification \(search\)](#) | [Certification of Persons \(search\)](#) |

[Inspection \(search\)](#) | [Validation and Verification \(search\)](#)

| [Proficiency Testing Providers \(search\)](#)

b.1.2 Organizmat akreditues që janë anëtarë të marrëveshjeve të njohjes reciproke (MRA) me ILAC (Organizmin Ndërkombëtar të Akreditimit të Laboratorëve) do t'i gjeni në linkun: <http://ilac.org/signatory-search/>.

Kur klikoni në këtë link do t'ju shfaqet lista e organizmave akreditues sipas rendit alfabetik dhe në kolonën e katërt me emrin "**Scope**" do të gjeni fushat për të cilat organizmi ka nënshkruar: psh, në rastin e ACCREDIA, në kolonën e katërt ka të shkruar: kalibrim, testim, testim mjekësor dhe inspektim.

» ILAC MRA SIGNATORY SEARCH

Paste this code to your website to host the ILAC MRA Search facility

SEARCH SIGNATORIES



Accreditation Body: Acronym: Economy: Scope:

ACCREDITATION BODY:

All A B C D E F G H I J K L M N O P Q R S T U V W X Y Z

Find an Accredited Laboratory or Inspection Body

Use this directory to find an accreditation body in the economy where you require the calibrations, testing or inspections to be carried out. You can also search their online directory via the link provided for some accreditation bodies.

» SEARCH RESULT: SIGNATORIES TO THE ILAC MUTUAL RECOGNITION ARRANGEMENT

Name	Economy	Scope	Original Signing Date	Website & Accredited Facilities
 ACCREDIA ACCREDIA - L'Ente Italiano di Accreditamento	ITALY	Calibration: ISO/IEC 17025 Testing: ISO/IEC 17025 Medical Testing: ISO 15189 Inspection: ISO/IEC 17020	07 Oct 2010 02 Nov 2000 02 Nov 2000 07 Nov 2012	Website Accredited Facilities
ATS	SERBIA	Calibration: ISO/IEC 17025	24 May 2012	Website

b.1.3 Organizmat akreditues, që janë anëtarë të marrëveshjeve të njohjes reciproke (MLA) me IAF (Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit), do t'i gjeni në linkun http://www.iaf.nu/articles/IAF_MEMBERS_SIGNATORIES/4.

Kur klikoni, do t'ju hapet faqja që liston të gjithë shtetet.



[In](#)
[fb](#)
[tw](#)

Search

[HOME](#)
[ABOUT US](#)
[IAF MLA](#)
[IAF MEMBERS & SIGNATORIES](#)
[PUBLICATIONS](#)
[NEWS & EVENTS](#)
[CONTACT US](#)
[FAQ](#)

- IAF Members & Signatories
- Association Members
- Regional Accreditation Groups
- Observer Organisations

IAF Members & Signatories

Accreditation Body Membership of IAF is open to bodies that conduct and administer programmes by which they accredit bodies for certification/registration of quality systems, products, services, personnel, environmental management systems as well as other programmes of conformity assessment. Accreditation body members must declare their common intention to join the IAF Multilateral Recognition Agreement (MLA) recognising the equivalence of other members' accreditations to their own.

View List By: [Name](#)

This list is a copy of the official IAF MEMBER LIST, in accordance with Article II Section 4 of the Bylaws.

Full contact details are provided.

Albania	Korea, DPR
Argentina	Korea, Republic of
Australia & New Zealand	Kosovo
Austria	Luxembourg
Belarus	The former Yugoslav Republic of Macedonia
Belgium	Malaysia
Brazil	Mauritius
Bulgaria	Mexico
Canada	Morocco
Chile	Netherlands
China	Norway
Chinese Taipei	Pakistan

MEMBERS LOGIN

Email

Password

[Forgot Password?](#)

[DOWNLOAD BROCHURE](#)



**Certified Once
Accepted Everywhere**

[Publications](#)
Access and download IAF publications
[Click Here>>](#)

[IAF Members & Signatories](#)
Contact details for IAF members, associates and related bodies
[Click Here>>](#)

Klikoni tek shteti të cilit i përket organizmi akreditues dhe në informacionin që merrni nën titullin **IAF-MLA**, gjenden fushat e nënshkrimit të MLA, psh. klikuam tek Belgjika dhe na shfaqet kjo pamje, ku poshtë titullit IAF MLA gjeni fushat, për të cilat Belgjika ka nënshkruar IAF- MLA.

Ju sjellim në vëmendje që tek website i IAF do të gjeni vetëm ato organizma akreditues që kanë nënshkruar MLA, për fushën e çertifikimit.



[in](#)
[fb](#)
[tw](#)

Search

[HOME](#)
[ABOUT US](#)
[IAF MLA](#)
[IAF MEMBERS & SIGNATORIES](#)
[PUBLICATIONS](#)
[NEWS & EVENTS](#)
[CONTACT US](#)
[FAQ](#)

- IAF Members & Signatories
- Association Members
- Regional Accreditation Groups
- Observer Organisations

IAF MEMBERS & SIGNATORIES

Accreditation Body Member

Economy:	Belgium
Body:	BELAC
Contact:	Mr. Bruno Buts Technical Manager Inspection and Certification



Belgian Accreditation Structure
 BELAC secretariat
 Boulevard du Roi Albert II, 16
 1000 Brussels
 Belgium
 Telephone: +32 2 277 5434
 Facsimile: +32 2 277 5441
 Email: belac@economie.fgov.be
 Website: <http://belac.fgov.be>

Code of Conduct Adopted: 03 December 2003

IAF MLA

Main scopes

- Management system certification - ISO/IEC 17021-1
- Product certification - ISO/IEC 17065 - 09 Oct 2004
- Certifications of persons - ISO/IEC 17024 - 20 Oct 2016

Sub scopes

Level 4

- MS: ISO/IEC TS 17021-3 - 29 Sep 1999
- MS: ISO/IEC TS 17021-2 - 09 Oct 2004
- Product: GlobalG A.P. IFA General Regulations - 22 May 2014

Level 5

- MS: ISO 9001 - 29 Sep 1999
- MS: ISO 14001 - 09 Oct 2004
- Product: GlobalG A.P. IFA CPCCs - 22 May 2014

MEMBERS LOGIN

Email

Password

[Forgot Password?](#)

[DOWNLOAD BROCHURE](#)



The value of accredited certification



The value of accredited certification Survey Report

The value of accredited certification Survey Report

[Publications](#)

B.2 Si mund të gjendet që një OVK është e akredituar nga një organizëm akreditues dhe cila është fusha e akreditimit?

b.2.1 Nëse organizmi akreditues është anëtar i EA-MLA, ekzistojnë dy mundësi:


- ose do të klikoni në faqen zyrtare të organizmit akreditues dhe tek rubrika **"accredited bodies"** do të gjeni emrin e OVK dhe fushën e akreditimit,
- ose tek **"Activities"** që gjetët më sipër klikoni tek **"search"**, pas vlerësimit të konformitetit që keni kërkuar.

Do t'ju shfaqet lista e OVK të akredituara nga ai organizëm akreditues.

Pasi të klikoni tek OVK që dëshironi dhe do t'ju shfaqet fusha e akreditimit.

b.2.2 Nëse organizmi akreditues është nënshkruar i ILAC-MRA, atëherë po të klikoni tek emri i shtetit do t'ju shfaqet një pamje e tillë psh. rasti kur kemi klikuar tek Austria.

» ILAC MRA SIGNATORY CONTACT DETAILS



Name : Akkreditierung Austria

Acronym : Akkreditierung

Membership Category : Full Member (ILAC MRA signatory)

Economy : AUSTRIA

ILAC MRA Scope :

Calibration: ISO/IEC 17025	22 Sep 2002
Testing: ISO/IEC 17025	22 Sep 2002
Medical Testing: ISO 15189	22 Sep 2002
Inspection: ISO/IEC 17020	24 Oct 2012

Contact Name : Mr. Norman Brunner

Phone : +43 1 71100 805411

Fax : +43 1 71100 8045411

Email : norman.brunner@bmdw.gv.at

Website : <http://www.en.bmdw.gv.at/accreditation>

Accredited Facilities : <http://www.bmdw.gv.at/TechnikUndVermessung/Akkreditierung/Seiten/AkkreditiertePIZ-Stellen.aspx>

Po të klikoni "**Accredited facilities**" do t'ju shfaqet lista e gjithë OVK të akredituara nga ai organizëm akreditues (shtet).

Klikoni tek emri OVK dhe merrni informacionin, nëse është i akredituar apo jo dhe cila është fusha e akreditimit.

B.2.3 Nëse është nënshkrues i IAF-MLA, klikoni në faqen zyrtare të internetit të organizmit akreditues dhe nën rublikën "**Accredited bodies**", do të merrni informacion në lidhje me vlefshmërinë e akreditimit dhe fushën e akreditimit.

Nëse nuk mund të merrni dot informacion sipas rrugëve të mësipërme, atëherë mund të kontaktoni me email me organizmat akreditues në adresat e tyre përkatëse.